

### Hyn në fuqi Ligji nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”

#### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar–Qershor 2021
- Zhvillimet e Tregut të Titujve të Qeverisë, Janar–Qershor 2021
- Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30.06.2021

#### Zhvillime të tjera

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloret:

- “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm”
- “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”

#### Publikime Profesionale

- Global Risk Regulator - A do ta mbështesë MiCA “revolucionin kripto” të BE-së?
- IOSCO - Raport Konsultimi “Vlerësimi mbi treguesit e Mjedisit, Socialë e të Qeverisjes si edhe Ofruesit e të Dhënave”
- OECD – Economic Outlook – “Një shërim jo i zakonshëm”

#### Informacione Ndërkombëtare

- Bullgari ○ Gjermani ○ Poloni ○ Republika Çeke ○ Rumani ○ Rusi ○ Serbi ○ Slloveni

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## Hyn në fuqi Ligji nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”

Ligji nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” gjendet në faqen zyrtare të Autoritetit:

<https://amf.gov.al/pdf/ligje/Ligji322021.pdf>



Faqe Kryesore ▶ Legjislacioni ▶ Ligje ▶ [Tregu i Sigurimeve]

Ligji nr. 32/2021, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 korrik 2021. Ligji rregullon sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit dhe [...]

Miratoi: Kuvendi; Hyn në fuqi: 01/07/2021

VERIFIKONI POLICËN

TUAJ ▶

Më 1 korrik 2021, hyri në fuqi Ligji nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Ligji, i miratuar në datën 16 mars 2021 në Kuvendin e Shqipërisë, rregullon sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit dhe përfshin:

- Sigurimin e përgjegjësishë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;
- Sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik;
- Sigurimin e përgjegjësishë së pronarit/përdoruesit të mjetit lundrues për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;
- Sigurimin e përgjegjësishë së pronarit/përdoruesit të avionit për dëmet e shkaktuara palëve të treta dhe pasagjerëve nga përdorimi i këtij avioni.

Ligji nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” gjendet në faqen zyrtare të Autoritetit:

<https://amf.gov.al/pdf/ligje/Ligji322021.pdf>

# VËSHTRIM MBI TREGJET


## Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar-qershor 2021

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-qershor 2021 kapën vlerën 8,866 milionë lekë, ose 17.53% më shumë se në periudhën janar-qershor 2020. Gjatë periudhës janar-qershor 2021, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 467,511 me një rritje prej 7.48% krahasuar me periudhën janar-qershor 2020.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.34% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.65%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 42.68% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 57.32% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-qershor 2021, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 3,742 milionë lekë, ose 8.3% më pak se në periudhën janar-qershor 2020, ndikuar kryesisht nga pagesa e konsiderueshme e dëmeve të tërmeteve përgjatë vitit 2020. Gjatë periudhës janar-qershor 2021, dëmet e paguara bruto nga sigurimi motorik kapën vlerën 2,076 milionë lekë duke pësuar një rritje me rreth 51.13% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### Struktura e tregut të sigurimeve, janar-qershor 2021 (Në %)



Gjatë periudhës janar-qershor 2021, dëmet e paguara bruto të sigurimit motorik kapën vlerën 2,076 milionë lekë duke pësuar një rritje me rreth 51.13% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

## Zhvillimet e tregut të Titujve të Qeverisë, janar-qershor 2021

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2021, u dominua në masën 64.84% nga transaksione në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 35.16% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 82.57% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të titujve të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2021, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim”, përkatësisht me 51.68% dhe 34.42% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për periudhën janar-qershor 2021 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.95% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.


### Transaksionet e grupeve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-qershor 2021, ka pasur një ulje prej 301 milionë lekë ose 17.19% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020. Numri i transaksioneve i llojit B është ulur në masën 20.93%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-qershor 2021, ka pasur një ulje prej 364 milionë lekë ose 26.32%, gjithashtu pati një ulje në numrin e transaksioneve në masën 7.30%, krahasuar me periudhën janar-qershor 2020.

Në totalin e transaksioneve B dhe C të marra së bashku, vërehet ulje në vlerë absolute me rreth 665 milionë lekë, krahasuar me janar-qershor 2020.

Tregu me pakicë i Titujve të Qeverisë, janar-qershor 2021 (Në %)



Gjatë periudhës janar-qershor 2021, pjesëmarrja në treg u dominua nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.95% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

## Zhvillimet e tregut të fondeve të investimeve, 30.06.2021


Gjatë periudhës 30.06.2021, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan aktivitetin e tyre nëntë fonde investimi. Fondi i investimeve “Raiffeisen Prestigj”, “Raiffeisen Invest Euro”, “Raiffeisen Vizion” dhe “Raiffeisen Mix” të administruara nga shoqëria “Raiffeisen Invest”, fondi i investimeve “Credins Premium” nën administrimin e shoqërisë administruese “Credins Invest”, fondi “WVP Top Invest” dhe fondi “WVP GLOBAL” administrohet nga shoqëria “WVP Fund Management Tirana sh.a”, fondi i investimeve “Albsig Standard” nën administrimin e shoqërisë administruese “Albsig Invest” sh.a, fondi “ABI EIA” administrohet nga shoqëria “ABI Invest”.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 30.06.2021, vlera neto e aseteve të fondeve, arriti rreth 71.85 miliardë lekë me një rritje prej 4,448 milionë lekë ose 6.6%, krahasuar me 31.12.2020.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 64.22% të aseteve të fondeve, me një rritje prej 0.68% krahasuar me 31.12.2020.


Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 30.06.2021 është 35,906 me një rritje prej 9.95% krahasuar me 31.12.2020.

### Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të investimeve (Në %) 30.06.2021



Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 30.06.2021, vlera neto e aseteve të fondeve, arriti rreth 71.85 miliardë lekë me një rritje prej 4,448 milionë lekë ose 6.6%, krahasuar me 31.12.2020.

## AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloret:



Projektregulloret gjenden në:

- ✓ [https://amf.gov.al/pr\\_ojekt.asp?id=71](https://amf.gov.al/pr_ojekt.asp?id=71)
- ✓ [https://amf.gov.al/pr\\_ojekt.asp?id=72](https://amf.gov.al/pr_ojekt.asp?id=72)

## 1. AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” ka hartuar projektregulloren “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm”. Dokumenti publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun e mëposhtëm: <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=71>

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave të funksionimit, identifikimit dhe raportimit të të dhënave të shitjes së kontratave të sigurimit të detyrueshëm në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve.

## 2. AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” ka hartuar projektregulloren “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”. Dokumenti publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun e mëposhtëm: <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=72>

Kjo rregullore përcakton rregullat, procedurat dhe metodologjinë e llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.



Regions / Europe

## Will MiCA support the EU's crypto revolution?

Justin Pugsley | July 7, 2021



The EU sees crypto with a mixture of trepidation and optimism, but still has a unique chance to transform the bloc into a world leader in the technology depending on how it regulates it.

### **A do ta mbështesë MiCA revolucionin krypto të BE-së?**

**Justin Pugsley**

<https://www.globalriskregulator.com/>

*Rregullimet e Komisionit Evropian për Tregjet në Kripto-Asete (Markets in Crypto-assets - MiCA) janë një kuadër rregullator i zhvilluar që nga viti 2018 për të ndihmuar në rregullimin e krypto-aktiveve që aktualisht janë jashtë fushës së veprimit dhe ofruesit e tyre të shërbimeve në BE dhe për të siguruar një regjim të vetëm licencimi në të gjitha shtetet anëtare deri në vitin 2024.*

Bashkimi Evropian e sheh kripton me një përzjerje drithërimi dhe optimizmi, por ka ende një shans unik për ta shndërruar bllokun në një udhëheqës botëror në teknologji, në varësi të mënyrës se si e rregullon atë.

Rregullorja e tregjeve në krypto-aktivet (MiCA) është një veprim i guximshëm, i cili mund të mbështesë një valë të inovacionit evropian që tashmë ka filluar. Por ka aspekte të MiCA që shqetësojnë disa burime të industrisë. Rregullorja po kalon ende nëpër fazat e saj legislative, dhe është pjesë e një pakete më të gjerë dixhitale nga Komisioni Evropian.

# IOSCO publikon Raport Konsultimi “Vlerësimi mbi treguesit e Mjedisit, Socialë e të Qeverisjes si edhe Ofruesit e të Dhënave”

Environmental, Social and Governance (ESG)  
Ratings and Data Products Providers

Consultation Report



The Board  
OF THE  
INTERNATIONAL ORGANIZATION OF SECURITIES COMMISSIONS

CR02/21 | JULY 2021

This paper is for public consultation purposes only. It has not been approved for any other purpose by the IOSCO Board or any of its members.



<https://www.iosco.org/>

Bordi i Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Titujve (IOSCO) ka publikuar këtë Raport Konsultimi me qëllim që të ndihmojë anëtarët e IOSCO-s në kuptimin e implikimeve të aktiviteteve të vlerësimeve mbi treguesit e Mjedisit, Socialë dhe të Qeverisjes (Environmental, Social and Governance (ESG) dhe ofruesve të të dhënave (termi përfshin ofruesit e vlerësimeve të ESG, ofruesit e produkteve të të dhënave ESG, si dhe ofruesit që ofrojnë vlerësime ESG dhe produkte të të dhënave). Raporti propozon rekomandime për të zbutur rreziqet që lidhen me këto vlerësime ESG.

Përdorimi i vlerësimeve Mjedisore, Sociale dhe të Qeverisjes (ESG) dhe produkteve të të dhënave është rritur ndjeshëm në përgjigje të interesit në rritje të investitorëve për të investuar në kompani që marrin parasysh qëndrueshmërinë në mënyrën e drejtimit të tyre. Si rezultat, roli dhe ndikimi i vlerësimeve të ESG dhe ofruesve të produkteve të të dhënave në tregjet financiare në përgjithësi, dhe më konkretisht në ekosistemin e financave të qëndrueshme, është rritur ndjeshëm. Kjo ka bërë që disa rregullatorë të tregjeve të titujve të interesohen më shumë për aktivitetet dhe modelet e biznesit të këtyre ofruesve.

Duke pasur parasysh që kjo pjesë e tregut aktualisht nuk është brenda kompetencave tipike të rregullatorëve të titujve, IOSCO ka kërkuar të forcojë njohuritë e saj duke ndërmarrë një ushtrim për gjetjen e fakteve me vlerësuesit ESG dhe ofruesit e produkteve të të dhënave, përdoruesit e vlerësimeve ESG dhe produktet e të dhënave, dhe kompanitë që janë subjekt i këtyre vlerësimeve ESG ose produkteve të të dhënave.



## OECD publikon Peisazhi Ekonomik – “Një shërim jo i zakonshëm”



<https://www.oecd.org/economic-outlook/>

Perspektivat globale po përmirësohen, por performanca ndryshon shumë nga njëri vend në tjetrin.

Perspektivat për ekonominë botërore janë hapur, por kjo nuk është një rimëkëmbje e zakonshme. Ka të ngjarë që kjo rimëkëmbje të mbetet e pabarabartë dhe e varur nga efektiviteti i programeve të vaksinimit dhe politikave të shëndetit publik. Disa vende po rikuperohen shumë më shpejt se të tjerët. Korea dhe Shtetet e Bashkuara, pas rreth 18 muajsh, po arrijnë në nivelet e para-pandemisë të të ardhurave për frymë. Për pjesën më të madhe të Evropës pritet rimëkëmbje pas gati 3 vitesh. Në Meksikë dhe Afrikën e Jugut, mund të duhen midis 3 dhe 5 vjet për rimëkëmbjen.

Publikimi vijon me analizimin e disa nën çështjeve si:

- Projeksionet e rritjes ekonomike janë rishikuar dhe tendenca është rritëse;
- Më shumë goditje, më shumë punë;
- Ringritja e tregtisë ka shtuar më tepër rikuperimin e pabarabartë.

I gjithë informacioni është i shoqëruar edhe me një bazë të madhe të dhënash dhe analizash.

## **BULLGARI**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave zyrtare të Komisionit të Mbikëqyrjes Financiare, FSC, të Bullgarisë, tregu bullgar i sigurimeve arriti në 807 milionë BGN, ose rreth 413 milionë EUR, në fund të marsit 2021. Kjo shifër shënon një rritje prej 6.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 16% duke arritur vlerën e 150 milionë BGN, kryesisht e nxitur nga rritja 77% e raportuar nga policat e sigurimit të Jetës të lidhura me skemat e kursimeve. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 4% duke arritur në 657 milion BGN.

## **GJERMANI**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Shoqata Gjermane e Sigurimeve, GDV, vlerëson se përmbytjet e mëdha të datave 12-13 korrik 2021 në Gjermani shkaktuan humbje prej 4-5 miliardë EUR. Menaxheri i përgjithshëm i Shoqatës Gjermane të Sigurimeve, Joerg Asmussen theksoi se "dëmi ka të ngjarë të jetë edhe më i lartë se ai i përmbytjes në gusht 2020, në 4.65 miliardë EUR, duke e cilësuar këtë si një nga stuhitë më shkatërruese të viteve të fundit".

Sipas ekspertëve të Mynih Re, vlerësohet se stuhia "Bernd" shkaktoi stuhi të forta dhe reshje të mëdha në Zvicër, Gjermani Perëndimore, Belgjikë, Luksemburg dhe Holandë. Gjermania Perëndimore ishte veçanërisht e goditur, ku reshjet ishin aq të mëdha në shumë vende sa statistikisht ndodh, sipas të dhënave historike meteorologjike, më pak se një herë në 100 vjet. Uji që ngrihej shpejt, përmbytjet e shpejta dhe rrjedhat e baltës çuan në humbje katastrofike. Shumë ndërtesa u shembën, automjetet dhe urat u morën nga uji.

Një vlerësim i saktë i humbjeve në rajon nuk është ende i mundur. Ky vit me stuhi, përmbytje, shi të madh dhe breshër, cilësohet nga specialistët e sigurimeve si viti më i dëmshëm që prej vitit 2002. Në atë kohë, dëmi i siguruar nga stuhia ishte 10.9 miliardë EUR. Gjatë këtij viti, në qershor, shiu i madh dhe breshëri kishin shkaktuar një humbje të vlerësuar nga siguroresit prej 1.7 miliardë EUR.

Për të mbrojtur më mirë qytetarët nga pasojat financiare të ngjarjeve të tilla katastrofike, specialistët mendojnë si zgjidhje të përshtatshme edhe sigurimet e detyrueshme ndaj të tilla ngjarjeve. Megjithatë, siç kanë theksuar përfaqësuesit e GDV, "sigurimi i detyrueshëm nuk mund të marrë përsipër kostot e mungesës së adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike. Në rastin më të mirë, do të kishte kuptim nëse do të integrohej një koncept i ri i përgjithshëm për planifikimin e zonës dhe ndërtimit, si dhe për kontrollin ndaj katastrofave". Përndryshe, ky sigurim i detyrueshëm vetëm sa do të zbehte motivimin e pronarëve të shtëpive për t'u mbrojtur nga përmbytja dhe rreziqet e tjera ekstreme të motit.

## POLONI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas statistikave të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë, KNF, tregu i sigurimeve në vend arriti vlerën e 17.6 miliardë PLN, ose 3.8 miliardë EUR në fund të marsit 2021. Kjo rritje është 5.33% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, dëmet e paguara bruto dhe përfitimet e paguara nga siguruesit në vend u ulën me 3% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 10.2 miliardë PLN ose 2.2 miliardë EUR.

Sigurimet e Jo-Jetës zënë pjesën më të madhe në volumin e primeve të shkruara dhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 u rritën me 4.8% duke arritur në 12.1 miliardë PLN, ose rreth 2.6 miliardë EUR. Segmenti i sigurimeve të jetës u rrit me 6.5% duke arritur në 5.5 miliardë PLN, ose rreth 1.2 miliardë EUR.

Polonia konsiderohet si tregu më i madh i sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore.

## REPUBLIKA ÇEKE

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas informacionit të publikuar nga *Radio Praga International*, kompanitë e sigurimeve në Republikën Çeke vlerësojnë se dëmi i shkaktuar nga uragani shkatërrues i fundit të qershorit 2021 arriti në vlerën e 3.6 miliardë CZK ose rreth 140.5 milionë EUR.

Deri në fund të muajit qershor, numri i dosjeve me kërkesa për dëmshpërblim nga ky uragan arriti në 11,000 dosje me vlerë përafërsisht 90 milion EUR. Tornado goditi disa fshatra në Moravinë e Jugut, por siguruesit vlerësojnë se numri i përgjithshëm i kërkesave për dëmshpërblim mund të arrijë deri në 25,000. Siguruesit përlogarisin një vlerë mesatare që pritet të arrijë në afro 144,000 CZK.

Sipas njoftimit të Shoqatës Çeke të Siguruesve, kompanitë e sigurimeve shpallën gjendjen e fatkeqësisë natyrore, menjëherë në natën pas tornados. Ata krijuan një shtab të posaçëm krizash dhe aktivizuan ekipet lëvizëse me të gjithë punonjësit që mund të ndihmonin në këtë situatë. Rregullat e pagimit të përshpejtuar hynë në fuqi për të ndihmuar klientët me dëmtime katastrofike, për të ndihmuar në procesin e rimëkëmbjes.

Përveç shtëpive të dëmtuara, u dëmtuan edhe një numër i madh automjesh, humbjet e të cilave vlerësohen në mbi 9 milion EUR, me një kosto mesatare prej 1,560 EUR për çdo kërkesë për dëmshpërblim. Humbjet në të korrat e bagëtinë gjithashtu mund të shkojnë në 5.5 milionë EUR.

Sikurse raporton *Radio Praga International*, Ministria Çeke e Industrisë dhe Tregtisë ka filluar të pranojë kërkesa për kompensim nga kompanitë e biznesit, nën një program të veçantë të Ndihmës për dëmet e tornados.

## RUMANI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave tremujore të botuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë, ASF, në fund të marsit 2021, fondet private të pensioneve Rumune (Kolona II dhe Kolona III) akumuluan 83.34 miliardë RON si vlerë e aseteve totale. Kjo shifër është 33% më shumë krahasuar me një vit më parë. Vlera e aseteve totale të sistemit të pensioneve private zinte 7.9% të Prodhimit të Brendshëm Bruto të vendit.

Më poshtë renditen shifrat kryesore të fondeve të pensioneve të administruara në mënyrë private – Kolona II (janar-mars 2021):

- Vlera totale e aseteve - 80.24 miliardë RON;
- Vlera e aseteve neto - 80,19 miliardë RON;
- Numri i pjesëmarrësve, anëtarëve të regjistruar - 7.68 milionë;
- Kontributi mesatar i pjesëmarrësve - RON 197 / pjesëmarrës;
- Norma mesatare e ponderuar e kthimit - 6.10%;
- Pagesa të aseteve personale neto për pjesëmarrësit - afërsisht 64 milionë RON për 3,991 pjesëmarrës dhe përfitues.

Të dhënat kryesore të fondeve të pensionit vullnetar – Kolona III (janar-mars 2021) janë si më poshtë:

- Vlera totale e aktiveve neto - 3.10 miliardë RON;
- Numri i pjesëmarrësve të regjistruar në sistemin e pensioneve vullnetare - 534,760 persona;
- Kontributi mesatar - 145 RON / pjesëmarrës;
- Norma mesatare e ponderuar e kthimit e të gjitha fondeve të pensionit vullnetar me rrezik të lartë - 9.09%;
- Norma mesatare e ponderuar e kthimit e të gjitha fondeve të pensionit vullnetar me rrezik të mesëm - 7.79%;
- Pagesa të aseteve personale neto për pjesëmarrësit - afërsisht 27 milionë RON për 2,587 pjesëmarrës dhe përfitues.

## RUSI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sikurse njofton Agjencia Ruse e lajmeve *Russian News Agency*, TASS, Presidenti Vladimir Putin nënshkroi një ligj i cili përcakton procedurën për pranimin dhe veprimtarinë e kompanive të huaja të sigurimeve që mund të veprojnë në tregun rus të sigurimeve.

Ligji synon të përbushë detyrimet e Rusisë për të pranuar degë të kompanive të huaja të sigurimeve nga vendet anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) në tregun e brendshëm, duke siguruar një ekuilibër midis mbrojtjes së tregut kombëtar të sigurimeve dhe krijimit të një konkurrence të ndershme midis siguruesve të huaj dhe rusë. Në të njëjtën kohë, siguruesit e huaj konsiderohen si subjekte të pavarura të biznesit të sigurimeve në të njëjtin nivel me kompanitë ruse. Licencimi i veprimtarive të siguruesve të huaj është i kufizuar në llojet vullnetare të sigurimit, risigurimit, si dhe sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë civile të pronarëve të automjeteve.

Siguruesit e huaj kanë të drejtë të aplikojnë tarifa që llogariten në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar të shteteve ku janë regjistruar. Ata nuk i nënshtrohen kërkesës për të paraqitur provigjone mbi formimin e rezervave të sigurimit tek autoriteti mbikëqyrës i sigurimeve ruse. Në të njëjtën kohë, siguruesit e huaj janë të detyruar të pasqyrojnë të gjitha operacionet në territorin e Federatës Ruse, përmes degëve të krijuara prej tyre në bazë të kontratave të sigurimit dhe risigurimit në bazat e të dhënave të sistemeve të informacionit. Të dhënat nga sistemet e informacionit të siguruesve do të ruhen në bazat e të dhënave për të paktën pesë vjet.

## SERBI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas statistikave të publikuara nga Banka Kombëtare e Serbisë, NBS, siguruesit serbë përfunduan tremujorin e parë të 2021 me vlerën totale të primeve të shkruara bruto prej 27.81 miliardë RSD, ose rreth 236.6 milionë EUR. Kjo shifër është 3.22% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Ndërkohë pagesat totale të dëmshpërblimeve nga siguruesit në vend u ulën me 27%, duke arritur në 11.64 miliardë RSD. Kjo ishte më shumë e lidhur me rënien e nivelit të pagesave të dëmshpërblimit për dy klasat e pronave, rënie që arriti në -84%.

## SLLOVENI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas raportit për tremujorin e parë të vitit 2021, të Shoqatës Sllovene të Sigurimeve, tregu slloven i sigurimeve arriti në 724 milionë EUR në fund të tremujorit, me një rritje 3% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me mbi 2%, duke arritur në 193.5 milionë EUR. Shkaku për këtë rënie të primeve lidhej më shumë me uljen prej 7% të policave tradicionale të sigurimit të Jetës, si edhe ulja e portofolit të produkteve *Unit Link* të lidhura me skemat e kursimeve.

Tregu i sigurimit të Jo-Jetës raportoi një normë pozitive rritjeje, prej 2.6% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë, duke arritur në 530.3 milionë EUR.

Vlera totale e dëmeve të paguara arriti në rreth 402 milionë EUR, nga të cilat rreth 83 milionë EUR ishin pagesa të dëmshpërblimeve për policat e sigurimit motorik.



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)